



BASHKIMI EVROPIAN MISIONI VËZHgues I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË PËR MEDIA: EUEOM/2013/03

Shpërndahen në terren 20 vëzhgues afatgjatë të Bashkimit Evropian

Prishtinë, 12 tetor 2013 – Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MBEVZ) i ka dërguar sot 20 vëzhgues afatgjatë (VA) në mbarë Kosovën. Dhjetë vetura me ekipe të vëzhguesve të BE-së janë nisur nga Prishtina këtë mëngjes për të shkuar në komunat, në të cilat do të qëndrojnë deri në fund të procesit të zgjedhjeve.

“Roli ynë është që të realizojmë një vëzhgim gjithëpërfshirës të tërë procesit të zgjedhjeve si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë rajonal, në Prishtinë dhe në të gjitha anët e Kosovës. Përveç ekipit kryesor të përbërë nga tetë ekspertë me seli në Prishtinë, 20 vëzhgues afatgjatë do të jenë sytë dhe veshët tanë në terren dhe do të na ndihmojnë që të mbledhim informata të besueshme” – tha Peter Palmer, zëvendëseshif i Misionit Vëzhgues me rastin e nisjes së VA-ve nga Prishtina.

Gjatë vëzhgimit të procesit, VA-të do t’i përmbahen një kodi të sjelljes, në të cilin përcaktohet, mes tjerash, se ata “do t’i marrin përsipër detyrat e tyre në mënyrë diskrete”. Ata do t’i përmbahen një metodologjie të përkufizuar qartë, për t’u siguruar që informatat për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të mblidhen sistematikisht.

Vëzhguesit do të takohen me zyrtarë qeveritarë dhe të zgjedhjeve si dhe me përfaqësues të partive politike, gjyqësorit, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Gjatë vëzhgimit VA-të do të përqendrohen në aktivitetet e fushatave të kandidatëve dhe partive politike, në raportimet e mediave dhe në përgatitjet për votim.

Deri në ditën e zgjedhjeve, atyre do t’iu bashkohen edhe 42 vëzhgues afatshkurtër dhe vëzhgues të tjerë nga ambasadat e BE-së. Ata pastaj do t’i vizitojnë vendvotimet, në mënyrë që ta mbikëqyrin hapjen e vendvotimeve si dhe operacionet e votimit dhe numërimit.

Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë është themeluar më 4 tetor të vitit 2013 për t’i vëzhguar zgjedhjet komunale që janë caktuar të mbahen më 3 nëntor dhe 1 dhjetor të vitit 2013. Ky mision udhëhiqet nga Roberto Gualtieri, shef i Misionit Vëzhgues dhe deputet i Parlamentit Evropian. MBEVZ-ja nuk ndërhyr në procesin zgjedhor dhe nuk ka asnjë autorizim për ta ndryshuar, përmirësuar, korrigjuar çfarëdo mangësie apo për të kërkuar ndryshime gjatë procesit zgjedhor.

Pas ditës së zgjedhjeve, shefi i Misionit Vëzhgues do të japë një deklaratë për vlerësimin preliminar të procesit nga ana e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Raporti përfundimtar – me rekomandime për zgjedhjet e ardhshme – do të publikohet në fillim të vitit 2014.

Për informata shtesë mediat mund t’i drejtohen Florence Marchal, zyrtare për Media dhe Komunikim me Publikun në MBEVZ, +386 49 73 77 08 – florence.marchal@eueomkosovo2013.eu